

VENDIM
Nr. 147, datë 26.12.2014

**PËRPËRCAKTIMIN E TARIFËS MESATARE TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 79, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për vitin 2015 do të jetë:

- 4.79 lekë/kwh për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti